



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

---

## RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 369/2021

Moszbatimi i Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 i datës 15 maj 2019, të organit të shkallës së dytë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Drejtuar: Z. Përparim Rama, Kryetar  
Komuna e Prishtinës

Prishtinë, më 26 prill 2022

## Qëllimi i raportit

1. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të ankuesit z. Ymer Havolli (në tekstin e mëtejshëm *ankuesi*) dhe mbështetet në shkresat e lëndës, faktet dhe provat që i ka në dispozicion Avokati i Popullit, lidhur me moszbatimin e Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 të datës 15 maj 2019, i nxjerrë nga organi të shkallës së dytë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i cili përcakton obligimin e Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës të veproi sipas kërkesës së ankuesit dhe Rregullores 01Nr.110-288305 për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karaktere të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik.

Për këtë raport ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm komuna) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për zbatimin, pa vonesa të mëtutjeshme, të Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 të datës 15 maj 2019, i nxjerrë nga organi të shkallës së dytë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

## Baza ligjore

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132, paragrafi 1, përcakton se: “ Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike”.
3. Neni 135, paragrafi 3, përcakton se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organe të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
  - “Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
  - “T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
  - “Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
  - “Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).



- *“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).*

Me dërgimin e këtij Raporti tek institucionet kompetente, si dhe publikimin e tij, Avokati i Popullit synon t’i kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

### **Përshkrimi i rastit**

5. Avokati i Popullit në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019, për Avokatin e Popullit, e ka pranuar ankesën e ankuesit parashtruar kundër Komunës së Prishtinës për moszbatim të Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 i datë 15 maj 2019.
6. Më 5 nëntor 2018, ankuesi pohon se kishte parashtruar Kërkesën Nr.05-350/02-0265139/18 me dokumente përcjellëse, në Drejtorinë e Urbanizmit (DU) në Komunën e Prishtinës, me të cilën kishte kërkuar caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm, me P+0, në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10244-0ZK Prishtinë.
7. Më 6 dhjetor 2018, DU në Prishtinë kishte marrë Vendimin 05 NR. 350/02-0265139/18, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e ankuesit.
8. Më 11 janar 2019, kundër vendimit për refuzim ankuesi kishte parashtruar Ankesën 05-070/01-7037/19 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) nëpërmjet DU të Komunës së Prishtinës.
9. Më 4 shkurt 2019, DU-ja në komunën e Prishtinës përmes Shkresës Nr. Prot. 392-2/19 e kishte dërguar dokumentacionin e ankuesit për shqyrtim në MMPH, përkatësisht në organin e shkallës së dytë.
10. Më 15 maj 2019, MMPH, si organi i shkallës së dytë, kishte nxjerr Vendimin A-18/19 me të cilin kishte shfuqizuar Vendimin 05 NR. 350/02-0265139/18 të DU-së në komunën e Prishtinës dhe kishte detyruar DU-në të vepronte sipas kërkesës së ankuesit dhe neneve 3 dhe 8 të Rregullores 01NR.110-288305, për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karaktere të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik. Ndërsa më 21 maj 2019, MMPH këtë vendim ia kishte përcjell edhe ankuesit.
11. Meqenëse DU në Komunën e Prishtinës nuk veproi sipas Vendimit A-18/19 të nxjerrë nga MMPH-së, dhe as nuk parashtroi padi për konflikt administrativ në gjykatë, ankuesi më 18 shtator 2019, në MMPH parashtroi Kërkesën Nr. 392-3/19, me të cilën kërkoi nga ministria që të lëshoi urgjencë për zbatimin e vendimit (A-18/19 ) të nxjerrë nga kjo ministri që tani ishte i plotfuqishëm.
12. Më 23 shtator 2019, zyra e sekretarit në MMPH ia kishte dërguar DU-së në komunë e Prishtinës Kërkesën Nr. Prot.392-3/19, me të cilën kërkoi raportin e kompletuar lidhur me kërkesën e ankuesit, njëherësh ta informonte më hollësisht për mos nxjerrjen e vendimit brenda afatit ligjor duke ia rikujtuar afatin 10 ditor për informim apo nxjerrje të vendimit.
13. Lidhur me kërkesën e parashtruar nga zyra e sekretarit në MMPH, më 2 tetor 2019, DU në Komunën e Prishtinës kishte marrë Vendimin 05 NR.350/02-0265139/18, dhe kishte refuzuar kërkesën e ankuesit për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e



ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10244-0 ZK në lagjen “Sofalia në Prishtinë.

14. Më 8 nëntor 2019, kundër Vendimit 05NR.350/02-0265139/18, ankuesi nëpërmjet DU-së në Komunën e Prishtinës kishte parashtruar Ankesën 05-070/01-274989/19 për MMPH, të cilën më 12 nëntor 2019, DU-ja e kishte dërguar në MMPH.
15. Më 29 nëntor 2019, zyra e sekretarit të MMPH-së kishte nxjerrë Vendimin A-249/19, me të cilin shpalli të paligjshëm Vendimin 05NR.350/02-0265139/18 i datës 2 tetor 2019 të DU-së në Komunën e Prishtinës.
16. Më 15 shtator 2020, DU në Komunën e Prishtinës nuk e zbatoi vendimin e plotfuqishëm, të MMPH-së, por në procedurën e rishqyrtimit me Vendimin 05NR.350/02-0265139/18 e refuzoi përsëri kërkesën e ankuesit për caktimin e kushteve ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës afariste me karakter të përkohshëm në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10244-0 ZK në lagjen “Sofalia në Prishtinë.
17. Pasi që DU në Komunën e Prishtinës nuk e zbatoi vendimin e plotfuqishëm të MMPH-së, ankuesi parashtrroi ankesë edhe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).
18. Më 11 shkurt 2021, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave në MAPL nëpërmjet postës elektronike, kërkoi nga Kryetari i Komunës së Prishtinës zbatimin e vendimit të MMPH-së, si dhe kishte dhënë sqarime se për çështjen e ankuesit kishte vendosur organi epror, dhe se vendimet e organeve më të larta janë të obligueshme për komunat.
19. Më 15 mars 2021, kundër Vendimit 05NR.350/02-0265139/18, ankuesi parashtrroi ankesë nëpërmjet DU në Komunën e Prishtinës për MMPH, ndërsa më 16 mars 2021, DU në Komunën e Prishtinës e përcjelli për shqyrtim në MMPH.
20. Më 13 gusht 2021, MMPH i kishte dhënë përgjigje ankuesit në ankesën e tij, duke i dhënë sqarime se: MMPH më datë 26 nëntor 2019, ka nxjerr Vendimin A-249/19 me të cilin e ka shpallur të paligjshëm Vendimin 05NR.350/02-0265139/18 i datës 2 tetor 2019 të DU në Komunën e Prishtinës, duke theksuar më tej se edhe Vendimi 05NR.350/02-0265139/18 i datës 15 shtator 2020, i organit të shkallës së parë, tani i ankimuar nga pala është nxjerrë jashtëligjshëm, se DU në komunën e Prishtinës ka qenë e obliguar ti përmbahet rekomandimeve të ministrisë, në të kundërtën e njëjta ka qenë e obliguar që brenda afatit ligjor të inicioj konflikt administrativ në gjykatë sipas udhëzimit juridik të dhënë me Vendimin Nr. A-249/19 i datë 26 nëntor 2019.  
  
Më tutje, në këtë përgjigje dhënë ankuesit nga ministria, sqarohet se Vendimi Nr. A-249/19 i datë 26 nëntor 2019 është nxjerrë konform dispozitave ligjore dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe Rregullores 01Nr.110-288305, të Kuvendit Komunal të Prishtinës për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik.
21. Më 13 shtator 2021, në DU në Komunën e Prishtinës ankuesi parashtrroi Kërkesën 05.Nr.070/01-192404/21 për respektimin e vendimeve të organit epror dhe vendosjen e ligjshmërisë.



22. Më 12 tetor 2021, Avokati i Popullit nëpërmjet një shkresë kërkoj nga Kryetari i Komunës së Prishtinës të informohet për veprimet e ndërmarra apo ato që priten të ndërmerren për zbatimin e Vendimit nr. A-18/19 të datës 15 maj 2019 të MMPH-së.
23. Më 28 tetor 2021, udhëheqësi i sektorit ligjor në Komunën e Prishtinës nëpërmjet shkresës e njoftoi Avokatin e Popullit, se DU në komunën e Prishtinës më 1 tetor 2021, kishte marrë vendim për hedhje poshtë të Kërkesës 05.Nr.070/01-192404/21 të datës 13 shtator 2021 të parashtruar nga ankuesi, duke lënë në fuqi Vendimin 05nr.350/02-0265139/18 të datës 15 shtator 2020 për refuzimin e kërkesës së ankuesit. Gjithashtu, Avokatit të Popullit i janë përcjell vendimet dhe shkresat e DU në komunën e Prishtinës dhe MMPH-së.

### **Analiza juridike dhe vlerësimet e Avokatit të Popullit**

24. Avokati i Popullit thekson se parimi i sundimit të ligjit është një ndër parimet kryesore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, themeli në të cilin bazohet dhe ndërtohet shteti i së drejtës si shtyllë kryesore e demokracisë së një vendi, me qëllimin kryesor mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.
25. Në këtë drejtim, me shtet të së drejtës kuptojmë një sistem ligjor që funksionon mirë, që është i lidhur me respektimin e hierarkisë së normave, ndarjen e pushteteve, barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Si nga pikëpamja e të drejtave të njeriut ashtu edhe nga aspekti i sundimit të ligjit, është me rëndësi që vendimet e plotfuqishme të organeve administrative të zbatohen nga organet që janë të obliguara t'i zbatojnë, ngase zbatimi i tyre përmban në vete edhe garantimin e një sigurie juridike e cila është një komponentë e rëndësishme e realizimit të parimit të sundimit të ligjit. Zbatimi unik i së drejtës, pra edhe i së drejtës administrative pa dyshim se është qëllim drejtë të cilit duhet synuar çdo sistem juridik i bazuar në sundimin e ligjit.
26. Në bazë të rrethanave të përcaktuara më sipër, Avokati i Popullit vë në pah që sipas përcaktimeve kushtetuese, rendi Kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit (neni 7, paragrafi 1).
27. Në po të njëjtën frymë juridike, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton qëllimin që të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave (neni 1). Për më tepër, me këtë ligj në mënyrë shprehimore janë përcaktuar veprimet e organeve të administratës në raport me ankesat e qytetarëve dhe veprimet e organeve të administratës në raport me detyrimet e dhëna nga organi i shkallës së dytë (neni 132, paragrafi 4 dhe 5).
28. MMPH respektivisht organi i shkallës së dytë kishte nxjerr Vendimin A-18/19 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin 05 NR. 350/02-0265139/18 të DU-së në komunën e Prishtinës dhe kishte detyruar DU-në të vepronte sipas kërkesës së ankuesit dhe neneve 3 dhe 8 të Rregullores 01 NR.110-288305, për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karaktere të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik.
29. Avokati i Popullit vlerëson se kundër Vendimit Nr. A-18/19 i datës 15 maj 2019 i nxjerr nga MMPH si organ epror, nga komuna e Prishtinës nuk ishte iniciuar padi për konflikt



administrativ në gjykatë. Me kalimin e afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, vendimi është bërë i plotfuqishëm, dhe si rrjedhojë organi i administratës, respektivisht DU në Komunën e Prishtinës është e obliguar ta zbatoj atë.

30. Avokati i Popullit, vlerëson se DU-së në komunën e Prishtinës në vend që të vepronte sipas detyrimit të dhënë me vendim përfundimtar dhe obligativ të organit epror në MMPH, në lidhje me çështjen e ankuesit ka vazhduar me nxjerrje të vendimeve të tjera (05NR.350/02-0265139/18, datë 15 shtator 2020; 05 Nr.02-0265139/18 datë 2 tetor 2019, i vlerësuar nga MMPH si i paligjshëm; 05 Nr.070/01-192404/21, datë 1 tetor 2021).
31. Avokati i Popullit rikujton se autoritetet kompetente kanë obligim pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor, e edhe në atë praktik, i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme
32. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson se do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi ligjor do të lejonte që një vendim administrativ i plotfuqishëm të mbetet i paefektshëm në dëm të ankuesit. Prandaj, moszbatimi i vendimeve administrative të plotfuqishme prodhon efekte negative, të cilat sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta respektojnë.<sup>1</sup>

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

33. Avokati i Popullit konstaton se vendimi i plotfuqishëm shpie tek pritshmëria e ligjshme dhe e arsyeshme e ankuesit, për faktin se atij i është dhënë një vendim nga organi i shkallës së dytë. Koncepti i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GjEDNj-së<sup>2</sup> “*pritshmëria legjitime*” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e ankuesit bazohet në vendimin e plotfuqishëm dhe të pa kundërshtuar në gjykatë.
34. Moszbatimi i vendimit të plotfuqishëm të organit epror respektivisht të organit të shkallës së dytë nga DU në komunën e Prishtinës është në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike, dhe si i tillë përbën shkelje të drejtave të njeriut, shkelje të drejtën për mjete juridike efektive, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.

Avokati i Popullit, bazuar në analizën e mësipërme ligjore dhe referuar argumenteve të lartpërmendura, në përputhje me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 5, të Ligjit për Avokatin e Popullit në cilësinë e rekomanduesit i :

### **REKOMANDON**

***Komunën e Prishtinës që:***


***Të ndërmarrë veprime në drejtim të zbatimit të Vendimit të plotfuqishëm A-18/19 të datës 15 maj 2019.***

<sup>1</sup> Neni 7, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

<sup>2</sup> Shih rastin Kopecky v.Slovakia , Aktgjykimi i dates 28 shtator 2004§45-52.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsytet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Naim Qelaj

Avokat i Popullit